



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:222977

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05424020

C.nr.3410/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Gëzim Shehu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.S. nga Prizreni, kundër të paditurës KRU "H.J." Sh.A - Prizren, me objekt të padisë kompensim dëmi, vlera e kontestit 3.100 euro, jashtë seance më datën 07 Mars 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Procedura në këtë çështje juridike kontestimore **NDËRPRITET**, për shkak të vdekjes së paditësit S.S. ish nga Prizreni .

II. Procedura e ndërprerë eventualisht do të vazhdoj kur trashëgimtarët e paditësit e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Paditësi S.S. nga Prizreni, më dt.20.10.2023 pranë kësaj gjykate, ka parashtruar padi, kundër të paditurës KRU "H.J." Sh.A - Prizren, me objekt të padisë kompensim dëmi, vlera e kontestit 3.100 euro.

Gjykata gjate procedimit në këtë çështje juridike është njoftuar se paditësi S.S. nga Prizreni ka vdekur .

Andaj gjykata konstatimin paditësi S.S. nga ish nga Prizreni, ka vdekur, e ka konstatuar në bazë të çertifikatës së vdekjes e datës 05.03.2024, me numër të serik V 10665845 , ku është konstatuar se paditësi S.S. ka vdekur me datë 11.01.2024.

Andaj duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 277 pika (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

Numri i lëndës: 2023:222977
Datë: 07.03.2024
Numri i dokumentit: 05424020

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr. 3410/2023, datë 07 Mars 2024

Gjyqtari

Gëzim Shehu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.